




Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo

AUTORITETI RREGULLATOR PËR SHËRBIMET E UJIT
REGULATORNI AUTORITET ZA USLUGE VODE
WATER SERVICES REGULATORY AUTHORITY



31. 12. 2019

Në mbështetje të nenit 19, paragrafin 1, të Ligjit Nr. 05/L-042, për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit, të shpallur në Gazetën Zyrtare Nr. 4/2016, datë 14. 01. 2016, dhe konform nenit 15 të Rregullores së ARRÚ Nr. 07/2016 për Përcaktimin e Tarifave të Shërbimit të Ujit në Kosovë, datë 23 Shtator 2016, si dhe rezultatet finale nga kalkulimet, përmes aplikacionit tarifar të DT, për tarifat gjegjëse të shërbimeve, Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit, merr këtë:

V E N D I M

për miratimin e urdhëresës së tarifave të shërbimeve (UTSH)

1. Miratohet Urdhëresa Tarifore e Shërbimeve (UTSH) e N. H "Ibër Lepenc" sh. a Prishtinë (ARRÚ/UTSH-12/08/2020), për aktivitetet themelore të shërbimit të ujit të patrajtuar me shumicë.
2. Lartësia e tarifave përfshinë vetëm vlerën faturale (përfshijet TVSH), për shërbimet themelore.
3. ARRÚ mund të bëjë korrigjime të jashtëzakonshme të UTSH, me kërkesë të N. H "Ibër Lepenc" sh. a, në përputhje me nenin 47 të Ligjit Nr. 05/L-042, për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit dhe në pajtim me nenin 16 dhe 17 të Rregullores 07/2016 Për Përcaktimin e Tarifave të Shërbimit të Ujit në Kosovë.
4. N. H "Ibër-Lepenc" sh. a. Prishtinë duhet të njoftojë Kompanitë e Ujësjetësve Regjional të cilat i furnizon me ujë të pa-trajtuar me shumicë me Tarifën e Shërbimit të përcaktuar nga ARRÚ-ja, sipas kësaj Urdhërese Tarifore të Shërbimit, me rastin e nënshkrimit të Kontratës për Shërbime ose t'u dërgojë të njëjtave kopjen e saj me faturën e radhës, pas shpalljes dhe publikimit të saj nga ARRÚ në portalin e internetit ; www.arru-rks.org.
5. Kjo UTSH publikohet në tre (3) gjuhë, dy nga të cilat janë zyrtare në Kosovë dhe në Gjuhën Angleze. Në rast mospërputhje në mes të versioneve (për gjuhët e përdorura) të UTSH-ës, do të mbizotërojë versioni i shkruar në Gjuhën Shqipe.
6. UTSH, hyn në fuqi më 1 janar 2020 dhe se vlen vetëm për vitin fiskal 2020 (01.01-31.12.2020).

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese në Komisionin Shqyrtues, në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi me shkrim.

Dërguar:

1 x 1 Arkivit të ARRÚ

1 x 1 Departamenti i Tarifave

1 x 1 Kryeshefit Ekzekutiv të N. H "Ibër Lepenc"





Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo


AUTORITETI RREGULLATOR PËR SHËRBIMET E UJIT
REGULATORNI AUTORITET ZA USLUGE VODE
WATER SERVICES REGULATORY AUTHORITY



ARRU/UTSH-12/08/2020

URDHËRESË TARIFORE E SHËRBIMEVE

N. H "IBËR LEPENC" SH. A PRISHTINË PËR VITIN 2020



E aplikueshme për:

KRU "Prishtina" sh. a Prishtinë
KRU "Mitrovica" sh. a Mitrovicë

Pasqyra e tarifave të shërbimit

NH "Ibër-Lepenc" Sh. A. Prishtinë për konsumatorët e vet do të aplikojë Tarifat e Shërbimit për furnizim të ujit me shumicë të pa trajtuar gjatë periudhës tarifore **01. 01 gjerë me 31. 12. 2020** nga procesi i rregullt tariforë tri vjeçar 2018-2020 sikurse janë dhënë në tabelën e më poshtme:

Tabela 1: Tarifat e ujit të pa trajtuar me shumicë

Numri rendor	KRU-të	Njësia tarifore	Viti 2020
1	Mitrovica	€/m ³	0.0163
2	Prishtina	€/m ³	0.0364

Shënim:

Për KRU "Mitrovica" sh. a Mitrovicë, tarifat janë të aplikueshme për Fabrikën e përpunimit të Ujit në Shipol të Mitrovicës, dhe për Fabrikën e Përpunimit të Ujit në Balincë të Vushtrrisë.

Për KRU "Prishtina" sh. a Prishtinë, tarifat janë të aplikueshme për Fabrikën e përpunimit të Ujit në Shkabaj të Prishtinës, dhe për Fabrikën përpunimit të ujit në Drenas.